

Titulli i lëndës:	Gjuhë Angleze
Mesimdhënesi:	Rina Krasniqi, Lektore
Statusi i lëndës:	Obligative
Kreditë ECTS:	3
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda Gjuhë Angleze në Fakultetin e Arkitekturës është e konceptuar si një kurs i Anglishtes për Qëllime Specifike (ESP), i zhvilluar në nivelin B2, me fokus në përdorimin funksional dhe akademik të gjuhës brenda kontekstit profesional të arkitekturës. Kursi ndërthur zhvillimin e aftësive gjuhësore me përmbajtje tematike që reflektojnë diskutet bashkëkohore të fushës së arkitekturës.</p> <p>Gjatë 64 orëve mësimore, studentët ekspozohen ndaj një game temash të lidhura ngushtë me arkitekturën, si stilet arkitekturore, arkitektura e qëndrueshme dhe e gjelbër, arkitektura dhe filmi, arkitektura dhe shoqëria, si dhe arkitektura rezistente ndaj fatkeqësive. Përmes këtyre temave, studentët zhvillojnë aftësitë e leximit kritik, shkrimit akademik dhe profesional, të dëgjimit dhe komunikimit oral, duke përdorur terminologji specifike të fushës.</p> <p>Një komponent i rëndësishëm i kursit është prezantimi oral, ku studentët ushtrojnë aftësitë e strukturimit të ideve, argumentimit dhe prezantimit profesional në anglisht, si dhe pjesëmarrja aktive në diskutime akademike. Aktivitetet e shkrimit përfshijnë tekste reflektuese, përmbledhje, analiza tematike dhe forma të shkrimit profesional, të përshtatura me nevojat e ardhshme akademike dhe profesionale të studentëve të arkitekturës.</p> <p>Kursi është content-based, ku anglishtja shërben si mjet komunikimi dhe analize për përmbajtje profesionale, duke i ndihmuar studentët të transferojnë njohuritë e fituara në lëndët e tjera të programit dhe t'i artikulojnë ato në mënyrë të qartë, të saktë dhe të përshtatshme në gjuhën angleze.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i lëndës Gjuhë Angleze në programin e Arkitekturës është zhvillimi i kompetencave gjuhësore akademike dhe profesionale të studentëve në nivelin B2, me fokus të veçantë në përdorimin funksional të anglishtes në kontekste të lidhura ngushtë me fushën e arkitekturës. Lënda synon të forcojë aftësitë e studentëve në komunikimin oral dhe të shkruar, duke i pajisur ata me fjalor, struktura gjuhësore dhe strategji diskursive që u mundësojnë të shprehin ide komplekse në mënyrë të qartë, të argumentuar dhe profesionale.</p> <p>Nëpërmjet temave bashkëkohore arkitekturore dhe aktiviteteve të bazuara në përmbajtje, kursi synon të zhvillojë mendimin kritik, aftësinë për lexim dhe analizë të literaturës profesionale, si dhe pjesëmarrjen aktive në diskutime akademike dhe prezantime orale. Një synim i rëndësishëm i lëndës është rritja e vetëbesimit gjuhësor të studentëve, duke i përgatitur ata për përdorimin e anglishtes në situata reale akademike dhe profesionale, përfshirë konferenca ndërkombëtare, punë kërkimore, bashkëpunime profesionale dhe komunikim</p>

	ndërdisciplinor në fushën e arkitekturës.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Në fund të kursit, studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdorë në mënyrë të saktë dhe funksionale terminologji dhe diskurs specifik të arkitekturës, duke pasuruar fjalorin profesional; • komunikojë qartë, rrjedhshëm dhe me korrektësi gjuhësore në situata akademike dhe profesionale të lidhura me arkitekturën; • aplikojë gjuhën angleze në nivelin B2 për nevoja akademike, analitike dhe specifike të fushës së studimit; • lexojë, kuptojë dhe analizojë tekste akademike dhe burime online relevante për arkitekturën, duke përzgjedhur informacionin e nevojshëm në mënyrë kritike; • realizojë prezantime orale të strukturuar dhe të marrë pjesë aktivisht në diskutime akademike mbi tema arkitekturore; • shkruajë tekste profesionale dhe akademike, përfshirë email-e formale dhe joformale, kërkesa zyrtare dhe letra motivuese, në gjuhën angleze.
Rëndësia dhe Aktualiteti i Lëndës	<p>Në kontekstin e globalizimit dhe ndërkombëtarizimit të profesionit të arkitekturës, njohja funksionale e gjuhës angleze profesionale përbën një kompetencë thelbësore për zhvillimin akademik dhe karrierën e ardhshme të studentëve. Anglishtja është gjuha dominuese e komunikimit profesional, literaturës shkencore, konferencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimeve ndërdisciplinore, duke e bërë atë një mjet të domosdoshëm për pjesëmarrje aktive në diskutet bashkëkohore të fushës.</p> <p>Kjo lëndë është aktuale dhe e rëndësishme pasi u mundëson studentëve të arkitekturës të përdorin anglishten në mënyrë të targetuar dhe kontekstuale, duke i përgatitur ata për prezantimin e ideve, projekteve dhe koncepteve arkitekturore në mjedise akademike dhe profesionale ndërkombëtare. Përmes zhvillimit të aftësive të komunikimit, analizës së literaturës dhe prezantimit profesional, kursi kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e konkurrueshmërisë së studentëve në tregun global të punës dhe në ndërtimin e një profili profesional të qëndrueshëm dhe të adaptueshëm ndaj sfidave bashkëkohore të profesionit.</p>
Metodat e mësimdhënies:	<p>Metodologjia e mësimdhënies në këtë lëndë bazohet në një qasje student-centered dhe ndërthur stile të ndryshme të të nxënies, përfshirë vizual, auditiv dhe kinestetik, me qëllim përfshirjen aktive të studentëve dhe zhvillimin e aftësive të tyre gjuhësore në kontekst profesional.</p> <p>Procesi mësimor realizohet përmes një game të gjerë metodash dhe aktiviteteve, si përdorimi i materialeve audiovizuale (video, dokumentarë, fragmente filmike), diskutime të strukturuar dhe tryeza të rumbullakëta, ushtrime individuale dhe në grup, si dhe aktivitete që synojnë zhvillimin e aftësive të folurit, të dëgjimit, të leximit dhe të shkrimit. Një vëmendje e veçantë i kushtohet punës në grup, seminareve tematike dhe prezantimeve orale, përmes të cilave studentët praktikojnë përdorimin e gjuhës angleze në situata reale akademike dhe profesionale.</p> <p>Ndërveprimi i vazhdueshëm midis studentëve dhe ligjëruesit, si dhe ndërmjet</p>

	vetë studentëve, përbën një element kyç të kursit, duke e vendosur studentin në qendër të procesit mësimor dhe duke inkurajuar autonominë, bashkëpunimin dhe reflektimin kritik.
	<p>Vlerësimi i studentëve në këtë lëndë realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe përqendrohet në zhvillimin e aftësive komunikuese, prezantuese dhe reflektuese në gjuhën angleze, në përputhje me natyrën content-based të kursit dhe nivelin B2.</p> <p>Notimi përfundimtar përbëhet nga këto komponente:</p> <p>1. Prezantim(e) orale - 75% e notës përfundimtare</p> <p>Prezantimet realizohen në grupe prej 4-6 studentësh, me kohëzgjatje 2 minuta për secilin student. Vlerësimi bëhet individualisht, duke u bazuar në kriteret si: struktura e prezantimit, qartësia e shprehjes, përdorimi i terminologjisë arkitekturore, korrektësia gjuhësore dhe aftësia për të komunikuar ide profesionale në anglisht. Temat e prezantimeve lidhen drejtpërdrejt me temat e trajtuara gjatë kursit dhe caktohen gjatë semestrit.</p> <p>2. Letër reflektues (Reflection paper) - 25% e notës përfundimtare</p> <p>Punimi reflektues synon të vlerësojë aftësinë e studentit për të reflektuar në mënyrë kritike mbi procesin e të nxënit. Në këtë punim, studenti pritet të trajtojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● çfarë ka mësuar gjatë kursit, ● zhvillimin e aftësive të tij në gjuhën angleze dhe në terminologjinë arkitekturore, ● sfidat e hasura gjatë kursit, ● mënyrën se si lënda ka ndikuar në të menduarit dhe artikullimin e koncepteve arkitekturore në gjuhën angleze.
Literatura primare:	Ruiz-Garrido, M. F., Palmer, J. C., & Fortanet-Gómez, I. (2010). <i>English for Professional and Academic Purposes</i> . Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
Literatura shtesë:	Gjatë ligjëratave do të përdoren worksheets të ndryshme , si dhe referenca dhe materiale arkitekturore relevante , të përzgjedhura në përputhje me temat e trajtuara dhe diskutimet e zhvilluara në klasë.